

VENDIM
Nr. 1046, datë 4.12.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 874, DATË 12.8.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKISONIMIN E BORDIT TË MBIKËQYRJES
PUBLIKE TË EKSPERTËVE KONTABËL, TË REGJISTRUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6 të nenit 4 të ligjit nr. 10 091, datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Nënndarja “iii” e shkronjës “a” të kreut II të vendimit nr. 874, datë 12.8.2009 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“iii) të mos kenë kryer auditime dhe të mos kenë qenë të punësuar apo të angazhuar në forma të tjera në një shoqëri auditimi prej të paktën tre vitesh para emërimit në pozicionin e anëtarit të bordit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama